

GJYKATA THEMELORE, DEPARTAMENTI I PERGJITSEM-Divizioni per Kundervajtje ne Ferizaj
Sipas Gjyqtares Nazife Beqiri me Sekretaren juridike Fatmire Mani duke vendosur në procedure kundërvajtëse kundër të pandehurit Hetem Ibrahimimi nga Ferizaj për shkak të kundërvajtjes nga neni 5,6 par.1.3, neni 9 dhe neni 17 par/1.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë (Ligji nr.04/L-050), dhe neneve 31,73,195 të Ligjit Mbi Kundërvajtjet me dt 31.08.2013 solli :

AKTVENDIM

Pezullohet Procedura kundervajtëse kunder te pandehurit Hetem Sabit Ibrahimimi I lindur me 04.11.1946, me venbandim ne Ferizaj, Rr."Ali Asllani " nr 16 Keshilltar ne Asamblene Komunale ,ne Ferizaj per Kundervajtjen e cila I ngarkohet, si ne kerkesen e AKK nga nenet 5,6 par/1.3 , neni 9 dhe neni 17 par/1.3 te ligjit nr.04/L-050, per shkak te mungeses se provave ne veshtrim te nenit 198 al 1 pika 8 ti ligjit mbi kundervajtjet.

Shpenzimet e procedures bien ne barre te gjykates.

Nga nje ekzemplar I ketij aktvendimi u dergohet paleve

Arsyetim

Agjencia Kunder Korrupsionit ne Prishtine, ka parashituar kerkesen nr.01 2196/2012 te dt.04.06.2012 per fillimin e procedures kundervajtëse ndaj te pandehurit Hetem Ibrahimimi per shkak te kundervajtjes nga nen. 5,6 par/1.3 neni 9 dhe neni 17 par/1.3 te ligjit nr.04/L-050 dhe ka propozuar qe I njeiti te shpallet pergjegjes dhe te denohet sipas ligjit.

Gjyqtari e udhehoqi procedure kundervajtëse dhe e degjoi te pandehurin I cili ne mbrojtjen e vet dhene para kesaj gjykate se nuk ka qene ne dijeni dhe nuk ka pranuar kerkese as formular per deklarimin e pasurise dhe tha se nuk e ka sqaruar zyrtari kontaktues I komunes se Ferizajt se eshte I obliguar ta beje nje gje te tille dhe se ka menduar qe formularin per deklarimin e pasurise qe e ka plotesuar kur jane zgjedhur per keshilltare te Asamblese Komunale te Ferizajt vlejne gjate gjithe mandatit sa jane keshilltare.

Qe te vertetoje gjendjen faktike Gjyqtarja ftoi per te deshmuar Naser Musen, zyrtar I pikes kontaktuese per nderlidhjen e puneve me AKK-ne prane Asamblese Komunale AK ne Ferizaj I cili ne deklaraten e tij nder te tjera theksoi se u'a ka shperndare-vendosur ne tavolinat e keshilltareve komunal formularet per deklarimin e pasurise dhe para fillimit te séances se kuvendit, kryesuesi Agim Aliu I ka njoftuar te gjithe delegatet se duhet ti plotesojne formularet dhe ti dergojne ne AKK. Ai poashtu prezentoi listen e delegateve qe ne ate mbledhje (ted t 09.03.2012) kane qene prezent .

Edhe deshmitari Afrim Matoshi zyrtar ne KK Ferizaj deklaroi se formularet ja ka dhene Naser Musa dhe te njejtiti I ka vendosur ne uleset e te gjithe keshilltareve te Asamblese Komunale e qe bashke me

| | | | |
|---------------------------|--|------------------------------|--|
| REPUBLIKA E KOSOVES | | AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT | |
| DEPARTAMENTI I PERGJITSEM | | DIVIZIONI PER KUNDERVAJTJE | |
| Dok. DPK/DMP | | Data 03-29-28/13 | |
| Nr. i flet. 02 | | Data 23-09-2013 | |
| Broj stranica | | Data | |
| Nr. pages | | Data | |

formularet kane patur edhe nje rekomandim per plotesimin e te njejteve. Nderkaq deshmitari Enis Sadiku, perfaqesues i AKK, vec tjerash tha se formularet (per deklarimin e pasurise) ka qene i obliguar tua dorezoje keshilltareve, zyrtari kontaktues N. Musa, e ne pyetjen e gjyqtares theksoi se nuk e din a eshte bere dorezimi personal i formulareve, (kerkeses) per deklarimin e pasurise e ne pyetjen tjeter u pergjigj se nuk kane e-mail – adresa te secilit keshilltar komunal. Gjyqtarja caktoi edhe seance ballafaqimi ne mes te pandehurit Hetem Ibrahimimi dhe zyrtarit kontaktues Naser Musa e qe ky i fundit nuk u paraqit ne kete seance nderkaq i pandehuri H. Ibrahimimi qendroi prane deklarates se dhene me 26.09.2012 duke shtuar se deklaroi me pergjegjesi morale e materiale se formulari-kerkesa per deklarimin e pasurise nuk i eshte dorezuar dhe as nuk ka qene i informuar se duhet ta beje nje gje te tille dhe ne gjykate ka sjellur vertetimin e AKK-se, se ka dorezuar formularin per deklarimin e prejardhjes dhe gjendjes se pasurise.

Ne baze te deklarates se te pandehurit deshmitareve, seances se ballafaqimit, bindjes se lire dhe shkresave tjera te lendes, gjyqtarja vlereson se nuk eshte deshmuar se AKK as personi kontaktues N. Musa se ka njoftuar te pandehurin mbi obligimin e deklarimit te pasurise, poashtu gjyqtarja konstatoi se kerkesa nuk permban perskrimin faktik te veprimeve nga te cilat rezultojne tiparet juridike te kundervajtjes.

Nga sa u tha me larte gjyqtarja konstatoi se nuk ka prova qe i pandehuri ka kryer veprën kundervajtese e cila i ngarkohet sipas kerkeses se AKK (si ne dispozitiv te ketij aktvendimi dhe ndaj te nejtut u pezullua procedura kundervajtese, ne veshtrim te nenit 198 al 1 pika 8 te LK.

Nga ajo qe u tha me lart u vendos si ne dispozitiv te ketij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE, DEPARTAMENTI I PERGJITSHEM - Divizioni per Kundervajtje ne Ferizaj

Sekretarja juridike

Fatmire Mani



KESHILLA JURIDIKE:

Kunder ketij aktvendimi te pandehurit dhe parashtuesit

Te kerkeses iu lejohet ankesa ne Gjykatën e Apelit - Divizioni per Kundervajtje ne Prishtine, ne afat prej 8 ditesh, pas marrjes se ketij aktvendimi, permes kesaj Gjykate.